

**EDMOND MALAJ****LEZHA NË MESJETË**

Lezha është një ndër qytetet më të vjetra shqiptare. Ajo ka qenë një vendbanim i fortifikuar që në kohët prehistorike me gjurmët në Majën e të Shëlbuemit<sup>1</sup>, dhe për të ka të dhëna historike të shumta edhe për periudhën e Antikitetit<sup>2</sup>, por në këtë artikull do të ndalemi në historinë mesjetare të këtij qyteti.

Siç vërejnë me saktësi medievistët Konstantin Jireček dhe Milan Shufflay, në Mesjetë, Lezhën e gjejmë nëpër dokumente me emra të ndryshëm. Nëpër dokumentet serbe këtë qytet e hasim me emrin *Ljesh* (*Lješ*), tek ato bizantine (në katalogët e peshkopëve, tek Konstantin Porfirogenetos dhe Anna Komnena) *Elissos*, nëpër dokumente mesjetare të shek. XIII-XV e ndeshim me emrat latinë *Lessium* (*Lexium*, *Lessum*) edhe *Alexium*, *Alessium*, dhe në italisht *Alessio*.<sup>3</sup>

Përveç këtyre emrave, Hahn na sjell për qytetin edhe një emër tjetër, i cili përdorej nga sllavët. Ky toponim i dytë por i panjohur sllav është “*Mrtav*” (*mortuus*)<sup>4</sup> që do të thotë “kufomë” dhe kjo sipas Hahn-it ka të

<sup>1</sup> Gjerak Karaiskaj, *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*. Tiranë: Pegi 2016, f. 20; shih edhe: Frano Prendi, Koço Zheku, “Qyteti ilir i Lisit. Origjina dhe sistemi i fortifikimit të tij”, në *Iliria*, 2, Tiranë: 1972, f. 244; Koço Zheku, *Lisi në shekuj*, redaktuar nga Jani Toçka, Tiranë: 8 Nëntori, 1988, f. 12.

<sup>2</sup> Në lidhje me historinë antike të qytetit të Lezhës shih artikullin me titull: Edmond Malaj, “Lezha gjatë periudhës së Antikitetit”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2017 (në proces botimi); shih më tej edhe: Erwin Pochmarks, Gëzim Hoxha, “Lissos: Quellen und Stadtgeschichte”, në *Römisches Österreich*, 25, Graz: 2005, f. 243-251, etj.

<sup>3</sup> Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [e të tjerë]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 123; shih edhe: Milan von Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*. Vorgelegt in der Sitzung am 24. April 1918. Kommissions-Verleger der Akademie der Wissenschaften in Wien. Wien/Leipzig: Hölder-Pichler-Tempsky A.-G. 1924, f. 27.

<sup>4</sup> *Albanesische Studien*, von Dr. jur. Johann Georg von Hahn., K. K. Consul für das östliche Griechenland. Nebst einer Karte Nebst einer Karte und anderen artistischen Beilagen. [Erstes Heft]. Jena: Friedrich Mauke, 1854, f. 92.

bëjë me përkthimin e toponimit “Ljesh” (*Lješ*) që përdorej për Lezhën, që në të vërtetë do të thotë “kufomë”<sup>5</sup> dhe ishte një fjalë e huazuar nga turqishtja.<sup>6</sup> Këtë toponim Shuflaj e has vetëm në dy dokumente raguzane të datave 18 maj 1372 (*ad Drinam in Mirteç*)<sup>7</sup> dhe 26 tetor 1377, në të cilat përmendet lokaliteti me emrin Merteç, Mirteç Drine (Mertesi/Mertesi në Dri), në lidhje me ngarkesën e një sasive druri lisi që marangozi Boxa Utołçiq (Boxa Vtolcich) u detyrohej dy raguzanëve.<sup>8</sup> Megjithatë Shuflaj është i mendimit që këtu mund të bëhet fjalë edhe për ndonjë degëzim të vdekur të lumit Drin.<sup>9</sup> Le të shohim tani më nga afër historinë mesjetare të këtij qyteti.

### Mesjeta e Hershme. Periudha e parë bizantine

Në lidhje me Mesjetën e hershme që e ka zanafillën e saj me rënien e Perandorisë Romake dhe kryesisht nëpërmjet “Dyndjes së popujve” kemi pak të dhëna. Dyndjet e para u bënë nga popuj të ashtuquajtur “barbarë” që ishin gotë, langobardë, avarë etj., të cilët nuk qëndruan gjatë. Në lidhje me kalimin e avarëve na dëshmojnë edhe thesaret e gjetura në Ersekë dhe në fshatin Vrap<sup>10</sup>, në rrethin e Tiranës, pra jo shumë larg Lezhës. Thesari i Vrapit u gjet në vitin 1901 nga një fshatar i zonës që po punonte tokën e tij<sup>11</sup> dhe përbëhej nga 41 objekte të ndryshme, disa prej tyre prej ari, me

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 137, ref. 92.

<sup>6</sup> M. von Šufflay, *Städte und Burgen...*, f. 27.

<sup>7</sup> “1372, 18 maii navigations ad Drinam (!) in Mirteç ad caricandum ibi lignanem”. *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens) (Nr. 555 et passim) Vindobonae MCMXVIII. Typis Adophi Holzhausenm, dok. nr. 347 (më tej: AAlb, II).

<sup>8</sup> “Boxa Vtolcich marangonus duobus Ragusinis se obliguat “de dando eis in Merteç Drine(!) usque ad menses II provime venturos trabes triginta de robore longos XIII” [...]”. *Po aty*.

<sup>9</sup> M. von Šufflay, *Städte und Burgen...*, f. 27.

<sup>10</sup> Matthias Hardt, *Gold und Herrschaft: Die Schätze europäischer Könige und Fürsten im ersten Jahrtausend*. Berlin: Akademie Verlag 2004, f. 183.

<sup>11</sup> Fshatari, emrin e të cilit studimet nuk e japin, gjatë punimit të arës hasi në një kazan dhe nuk u mor fort me përmbajtjen se çfarë kishte brenda, por shkoi e ua shiti kazanin për disa meshhide tre shqiptarëve të tjerë, të cilët mesa duket filluan të ziheshin për shkak të tij. Kjo grindje u mor vesh në Tiranë nga organet osmane të asaj kohe. Mytesarif Mehmet Hysni Beu u gjeti këtyre një kupë ari (pokal), të cilën ua konfiskoi dhe e dërgoi për ekzaminim në Stamboll, një pjesë tjetër përfundoi e shitur në Paris dhe si përfundim 39 pjesë të këtij thesari (me përjashtim të 2 pjesëve, asaj të

peshë 5,554 kg dhe të tjerat prej argjendti, me peshë 1,438 kg.<sup>12</sup> Objektet janë bizantine, pra duhet të jenë grabitur në qytete të ndryshme dhe ka shumë mundësi të kenë qenë në pronësi të Kuberit, të birit të Kuvratit që ishte *khagan* i avarëve dhe duhet të jenë sjellë në Shqipëri për shkak të një rebelimi. Se si kanë përfunduar të fshehura në malet shqiptare ky thesar mbetet akoma edhe sot një enigmë.<sup>13</sup>

Më vonë ndodhën dyndjet e popullsive sllave,<sup>14</sup> të cilat rreth vitit 545 filluan e zbritën me shumicë në jug duke kaluar lumenjtë Ister e Danub dhe në vitet 547-548 pushtojnë dhe shkatërrojnë shumë vende nëpër Ilirik e Traki<sup>15</sup> dhe i afrohen Durrësit.<sup>16</sup> Sa i përket Lezhës, dihet vetëm që, ajo në shekullin VI ishte një ndër tre qytetet kryesore të Provincës së Prevalit me qendër Shkodrën. Lezha që në atë periudhë quhej Lissos, përmendet edhe në listën e qyteteve të Herioklit, e cila ishte krijuar në shek. VI dhe shërbente si udhërrëfyes për administratën qendrore bizantine.<sup>17</sup>

Gjatë këtij shekulli, si shumë qendra të tjera urbane, edhe Lezha mori një goditje të rëndë, sepse në vitin 592 gjatë kohës së këtyre dyndjeve

---

Stambollit dhe një prej tyre në Paris) u blenë më vonë nga J. Pierpont Morgan († 1913) dhe u ruajtën edhe pas vdekjes së tij në Nju Jork nga i biri. Shih më tepër: Josef Strzygowski, *Altai-Iran und Völkerwanderung. Ziergeschichtliche Untersuchungen über den Eintritt der Wanderer - und Nordvölker in die Treibhäuser Geistigen Lebens. Anknüpfend an einen Schatzfund in Albanien.* Leibzig: J. C. Hinrichs'sche Buchandlung 1917, f. 1.

<sup>12</sup> M. Hardt, *Gold und Herrschaft ...*, f. 184.

<sup>13</sup> *Po aty.*

<sup>14</sup> Jahja Drançolli, "Kontaktet historike arbërore-sllave gjatë mesjetës", në *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë mesjetës*, Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar, 2008, f. 50.

<sup>15</sup> *La guerra gotica di Procopio di Cesarea*; testo greco, emendato sui manoscritti con traduzione italiana. A curi di Domenico Comparetti. Vol. Terzo, Roma: Forzani e C. Tipografi del Senato 1898, f. 311; shih edhe: Procopii Cesariensis, *De Bello Gothico*, Libri VII (III), 3-8, në *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, përgatitur nga Selim Islami (redaktor përgjegjës), Frano Prendi, Hasan Ceka, Skënder Anamali, Botim i katërt, Tiranë: Toena, 2002, f. 435.

<sup>16</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia.* Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen (më tej: AAlb. I), nr. 40; J. Drançolli, "Kontaktet historike arbërore-sllave ...", në *Arbërit...*, f. 50.

<sup>17</sup> Heriocrates Synecdemus, XVII, 656, në *Ilirët dhe Iliria ...*, f. 456; Frano Prendi, "Vazhdimësia etno-kulturore e Lisit në Mesjetë", në *Lis 6*, përgatitur nga Muzeu Historik i Lezhës, Lezhë: Lisitan, 1993, f. 8.

qyteti sulmohet nga barbarët (sipas Pulahës nga sllavët<sup>18</sup>) dhe mbahet prej tyre për një kohë të gjatë (*Lissus ab hostibus teneatur*)<sup>19</sup>. Kjo e dhënë na vjen nga një dokument kishtar, në të cilin thuhet që papa Gregori I, duke qenë se Lezha mbahej nga armiqtë, Gjonin, ipeshkvin e ikur lezhjan (lissitan) e ngarkon me detyrën e kryepriiftit në kishën e Skillaçit (*ecclesiae Scyllacinae*) në afërsi të Katanzaros.<sup>20</sup>

Pra, Papa e pranon me dashamirësi Gjonin, por me kusht që kur qyteti të rikthehej në lirinë e tij të mëparshme, edhe ipeshkvi Gjin të rikthehej tek grigja e tij.<sup>21</sup> Këta armiq duhet të kenë qenë pa dyshim sllavë, të cilët, siç e përmendëm edhe më sipër depërtojnë në vitet 548-550 deri në Durrës.<sup>22</sup> Këta e dëmtojnë rëndë qytetin e Lisit, siç kishin bërë edhe me provinca të tjera të Ilirisë duke u vërsulur me tërbim, dhe e vendosin atë nën zgjedhën e tyre, si rrjedhojë edhe ipeshkvi i qytetit arratiset dhe shkon në Romë.<sup>23</sup> Prej tyre u shkatërruan edhe qytete të tjera bregdetare si për shembull Salona dhe Epidaurum.<sup>24</sup>

Dokumenti kishtar që cituam më sipër ka një vlerë të madhe, sepse është më i hershmi që na dëshmon për ekzistencën e ipeshkvisë së Lisusit. Megjithatë krishterimi duhet të ketë hyrë në Lezhë në kohëra më të hershme, kjo për vetë faktin se ky qytet ishte portual dhe qendër qarkullimi. Farlati për dioqezën e Lisusit nuk përmend një datë më të hershme nga data 592, por thotë që “zanafilla e Kishës së Lisusit, edhe pse është e panjohur, mund ti referohet kohës, kur në Durrës depërtoi besimi i krishterë dhe i gjithë Epiri filloi të ndriçohej hyjnishëm nga drita

<sup>18</sup> Selami Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës”, në *Lissus*, Tiranë: Naim Frashëri, 1968, f. 96.

<sup>19</sup> “*Lissus ab hostibus teneatur*”. AAlb. I, nr. 40.

<sup>20</sup> “592, mense iulio. Gregorius I. papa Johannem, expulsus episcopum Lissitanum, vacuae ecclesiae Scyllacinae, dum Lissus ab hostibus teneatur, praeesse iubet cardinalem sacerdotem”. Po aty.

<sup>21</sup> *Illyrici Sacri. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis*. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë, Prishtinë: Arbi, 2004), f. 386.

<sup>22</sup> “*Sub hostibus haud dubie Slavi intelliguntur, qui iam a. 548 usque Eoidamnum (Dyrrhachium) progressi a 550 ...*”. AAlb. I, nr. 40.

<sup>23</sup> “*Cum Lissus a barbaris, fortasse, Slcavis, qui tum per illyrici provinciali imune grassabantur, in miserrimam vastitatem ac servitutum fuisset aducta ...*”. D. Farlati, *Illyricum Sacrum ...*, VII, f. 386.

<sup>24</sup> AAlb. I, nr. 40.

e Ungjillit.”<sup>25</sup> Që nga viti 592, kemi ndërprerjen e listës së ipeshkviëve të Lezhës për rreth 800 vjet. Shfaqet sërish si ipeshkvi në vitin 1385, por jo më siç ishte më parë nën juridiksionin e Mitropolisë greke të Dyrrahionit, por tani i përkiste Kishës latine (*episcopus Lesseniensis 1371*).<sup>26</sup>

Po gjatë kësaj periudhe të depërtimit të sllavëve pushoi së funksionuari edhe Kryeipeshkvia e Shkodrës, e cila zhduket në vitin 602, në kohën kur kryeipeshkëv ishte Konstanci<sup>27</sup>, i cili qe kryeipeshkvi i fundit, sepse më pas kjo qendër kishtare shfaqet në Mesjetë si ipeshkvi.

Ky pushtim sllav, që nga vitet 80 të shek. VI nuk u mjaftua më vetëm me plaçkitje, pasi fiset e tyre filluan të vendoseshin në territorin bizantin në numër gjithnjë e më të madh.<sup>28</sup> Pushtimi sllav, sipas F. Prendit duket se zgjati së paku deri në fillim të shek. VII,<sup>29</sup> duke i shkaktuar qytetit humbjen e shkëlqimit të tij dhe të rëndësisë dhe të dendësisë që kishte pasur në Antikitë. Dyndjet barbare dhe faktorë të brendshëm kishin krijuar një situatë mjaft të pafavorshme për ekzistencën dhe për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit, të cilat çuan gjatë shek. VII-VIII në tkurrjen e tij, sidomos në zonën e lagjeve të poshtme buzë Drinit.<sup>30</sup> Fuqia e kufizuar ekonomike e qytetit dëshmohej në mënyrë të tërthortë sidomos nga fusha e arkeologjisë, e cila nuk gjen në qytet mbetje nga ndërtimet monumentale, përse u përket këtyre dy shekujve.<sup>31</sup>

Megjithatë qyteti edhe gjatë kësaj periudhe të vështirë nuk qe i mbyllur në vetvete, sepse të dhënat arkeologjike dëshmojnë për tregti, shkëmbim mallrash dhe marrëdhënie zejtare me qytete të tjera si me Dyrrahun apo edhe me Gadishullin Italik. Në Lezhë gjatë shek. VII kishte edhe punishte ku prodhoheshin vegla pune, armë, stoli të bukura trupore dhe materiale të ndryshme qeramike të cilat furnizonin jo vetëm tregun lokal, por i çonin prodhimet edhe më tej.<sup>32</sup> Ky faktor i brendshëm e nxiti zhvillimin e mëtejshëm të Lezhës gjatë kësaj periudhe, por përveç këtij,

<sup>25</sup> “*Ecclesiae Alexiensis initia, quamvis ignota ad idem fere tempus referri possunt, quo Durrhachium Christiana religio invecata est, & Evangelii luce tota Epirus divinitus coepit illustrari*”, D. Farlati, *Illyricum Sacrum ...*, VII, f. 385.

<sup>26</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 123.

<sup>27</sup> D. Farlati, *Illyricum Sacrum ...*, VII, f. 307.

<sup>28</sup> Georges Castellan, *Histori e Ballkani (shekulli XIV-XX)*, përkthyer nga origjinali Arben Puto, Luan Omari, Tiranë: Çabej, 1996, f. 34.

<sup>29</sup> F. Prendi, “Vazhdimësia etno-kulturore...”, në *Lis 6*, f. 8.

<sup>30</sup> Po aty, f. 9.

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> Po aty, f. 12.

ndihmës ishte edhe një faktor tjetër, që konsistonte në riorganizimin administrativ të Perandorisë Bizantine dhe në krijimin e temës së Durrësit, në të cilën Lezha përfshihej si një qendër me rezerva të mëdha ekonomike.<sup>33</sup> Gjatë kësaj periudhe qyteti fortifikohet me mure të fuqishme rrethuese dhe sipër kodrës ku më parë kishte qenë Lisi antik, u ndërtua kështjella e Lezhës, e cila do të qëndronte deri me pushtimin osman në vitin 1443.<sup>34</sup>

### **Nën temën e Durrësit. Periudha e dytë bizantine**

Në shek. IX-X, qyteti fillon të njihet me një emër të ri *Elis* dhe hyn në një etapë të re zhvillimesh të pandërprera historike, ngaqë situata ekonomike-sociale fillon e fuqizohet, dhe marrëdhëniet feudale zgjerohen shkallë-shkallë si rrjedhojë e krijimit të shtresave feudale vendase.<sup>35</sup> Qyteti fortifikohet edhe më tepër dhe gjatë kohërave të sulmeve të normanëve Ana Komnena lëvdon pozicionin e fortë të kështjellës së paarritshme, prej së cilës bizantinët nëpërmjet detit furnizonin me ushqime dhe armë Durrësin, gjatë luftës kundër Boemundit.<sup>36</sup> Nga kjo mund të nxirret si konkluzion që qyteti ishte i fortifikuar mirë dhe ishte në lulëzim të plotë deri në fund të periudhës së sundimit bizantin, që i bie të jetë fundi i shek. XII.<sup>37</sup>

### **Periudha serbe**

Në kohën e zgjerimit të Mbretërisë Serbe të Rashës (1165-1195) gjatë sundimit të Stefan Nemanjas, Lezha së bashku me krahinat veriore të Shqipërisë u përfshi brenda kësaj mbretërie deri në vitin 1215.<sup>38</sup> Në kohën e Nemanjes qyteti nuk përmendet, porse shfaqet pak më vonë nën sundimin e mbretërve të mëvonshëm serb. Mihaeli I Angelos, despoti i Epirit ua merr qytetin nga duart sunduesve serbë, duke përfshirë brenda sundimit të tij edhe krahinat deri në Shkodër dhe bashkë me to edhe Principatën e Arbrit<sup>39</sup>. Por, situata ndryshoi sepse lufta midis despotatit të

<sup>33</sup> Po aty, f. 13; shih edhe: S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus*, f. 96.

<sup>34</sup> F. Prendi, “Vazhdimësia etno-kulturore...”, në *Lis 6*, f. 13.

<sup>35</sup> Po aty, f. 12.

<sup>36</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet...”, f. 123.

<sup>37</sup> M. von Šufflay, *Städte und Burgen...*, f. 27.

<sup>38</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës...”, në *Lissus*, f. 96.

<sup>39</sup> Po aty, f. 97.

Epirit dhe atij të Nikesë që po bëhej për fronin e perandorisë të shkatërruar tashmë nga kryqëzatat, e dobësoi pushtetin bizantin nga njëra anë, dhe çoi në fuqizimin e feudalëve shqiptarë,<sup>40</sup> sidomos gjatë gjysmës së dytë të shek. XIII. Ndër familjet feudale që më tepër kishin nën zotërim zonat në Fushën dhe në Malësinë e Lezhës mund të përmendim Jonimajt, Blinishtët, Dukagjinët dhe Skurajt. Por, edhe këto familje nuk mundën të fuqizoheshin më tepër, sepse kishin kundër pushtetin e Anzhuinëve, nën sundimin e Karl I Anzhusë (1272-1286), i cili iu kundërvu atyre që e kundërshtuan<sup>41</sup>, duke i konsideruar ata si tradhtarë e duke çuar shumë feudalë arbër në burgim në Brindisi të Italisë. Ndër këta mund të përmendim edhe Gjin Tanushin e Dukagjinëve.<sup>42</sup> Gjatë kësaj kohe për çudi në aktet tregtare Lezha përmendet shumë rrallë.<sup>43</sup> Karli Anzhu e konsideronte veten si mbret, pasi më 22 shkurt 1272 kishte shpallur në Napoli “*Regnum Albaniae*” (Mbretërinë e Arbërisë), dhe ishte vetëshpallur mbret i saj.<sup>44</sup> Në vitin 1292, mbreti serb Uroshi II Millutini e futi Durrësin nën mbretërinë e tij dhe që nga ajo kohë Mbretëria e Arbërisë hyri në vitin 1309 për të parën herë nën titullin e mbretërve serbë.<sup>45</sup>

Pasi në Mbretërinë Serbe erdhi në fron Stefan (Uroshi IV) Dushani, pushteti serb filloi që të përhapej sërish nëpër trojet arbërore duke përfshirë brenda saj edhe Lezhën. Ky monark ishte aq i pashpirt, sa që për pushtet vrau edhe të atin, me qëllim që të mos kishte pengesa dhe të hipte sa më shpejt në fron.<sup>46</sup> U vetëkurorëzua si “perandor (car) i parë i serbëve dhe i grekëve” më 1346 në Shkup.<sup>47</sup> Trupat e Stefan Dushanit pushtuan të gjitha trojet shqiptare, përveç Durrësit, i cili qëndroi edhe më tej nën

<sup>40</sup> Po aty.

<sup>41</sup> Shih më poshtë marrëveshjen me Blinishtët dhe të tjerët. AAlb I, nr. 333.

<sup>42</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës...”, në *Lissus*, f. 97.

<sup>43</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet...”, f. 123.

<sup>44</sup> Peter Bartl, *Shqiptarët. Nga Mesjeta deri në ditët tona*, përktheu Afrim Koçi, Tiranë: IDK 2017, f. 30.

<sup>45</sup> Milan Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët*, përktheu nga kroatishtja Hasan Çipuri, Tiranë: Toena 2004, f. 50-51.

<sup>46</sup> Ludwig von Thallóczy, *Të ndodhnit e Shqypnis prej një Gege që don vendin e vet*, përktheu nga gjermanishtja Stefan Zurani, botim i tretë, Shkodër: Botime Françeskane 2008, f. 136.

<sup>47</sup> *Atlas zur Weltgeschichte. Karten und chronologischer Abriss. Bd 1: Von den Anfängen bis zur Französischen Revolution. Mit 128 Kartenseiten. 7. Auflage.* München: dtv 1990, f. 205.

sundimin e Anzhuinëve.<sup>48</sup> Për të centralizuar dhe për të forcuar edhe më shumë pushtetin e tij në perandorinë e madhe serbe që kishte krijuar, në të cilën përfshiheshin territore nga Danubi deri në Akaia të Greqisë, ai bëri në vitin 1349 edhe kodifikimin e së drejtës (zakonik)<sup>49</sup>, që në histori hyri me emrin Kodi i Stefan Dushanit. Megjithatë, periudha e Stefan Dushanit nuk pati jetëgjatësi, sepse me vdekjen e tij u shpërbë edhe perandoria e tij e madhe.

Pas vdekjes së Stefan Dushanit dhe rënies së Perandorisë Serbe, në krahinën e Lezhës filluan të fuqizoheshin familje të ndryshme feudale shqiptare, ndër të cilat bien në sy Blinishtët dhe Dukagjinët. Por, edhe Balshajt, që ishin më në veri, kishin ndikimin e tyre në Lezhë dhe shpeshherë patën aty edhe rezidencën e tyre.<sup>50</sup> Gjatë kësaj kohe, ashtu si në qytetet e tjera si Shkodër, Ulqin, Tivar, Drisht etj., kishte pasur një zhvillim edhe në bashkësinë qytetare të Lezhës, e cila pas mbarimit të pushtimit serb duhet të jetë kthyer në një bashkësi e pavarur, por që nuk duhet ta ketë gëzuar gjatë si të plotë këtë pavarësi, pasi qytetet tërhoqën lakminë e fisnikëve feudalë shqiptarë, të cilët e respektuan vetadministrimin kundrejt një haraçi, të cilin bashkësitë e qyteteve qenë të detyruara t'ua paguanin atyre.<sup>51</sup>

### **Blinishtët**

Së pari ia vlen të përmenden këtu Blinishtët si e para familje fisnike që kishte pasur një pozitë të fuqishme në Lezhë, dhe si domene të tyre kryesore kishte fshatin e sotëm Blinisht në afërsi të Lezhës. Emri i tyre shfaqet nëpër shkrime të ndryshme edhe në forma të gabuara si *Bleusi*, *Bleuisti*, *Bletisti*, *Blevisci*, dhe ndoshta e kanë pasur origjinën nga fisi i Matjanëve (Matasei).<sup>52</sup> Blinishtët përmenden për herë të parë në vitin 1274, në kohën e sundimit të Anzhuinëve. Me këtë rast si i pari ndër ta përmendet Vladi, stratiot bizantin, i cili kishte lidhje me serbët.<sup>53</sup> Në një

<sup>48</sup> P. Bartl, *Shqiptarët ...*, f. 35.

<sup>49</sup> *Atlas zur Weltgeschichte ...* 1, f. 205.

<sup>50</sup> K. Jireček, "Skutari und sein Gebiet..." f. 123.

<sup>51</sup> Kristo Frashëri, *Historia e qytetërimit shqiptar. Nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 2008, f. 82.

<sup>52</sup> M. Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët ...*, f. 157; shih edhe: Milan Shufflay, *Histori e shqiptarëve të Veriut*, Studim Sociologjik, përktheu Abdullah Konushevci, Prishtinë: Nositi 2009, f. 26.

<sup>53</sup> S. Pulaha, "Vështrim mbi historinë e Lezhës ..." në *Lissus*, f. 97.

dokument të 1 dhjetorit 1274, emri i Vladit (Blado Bletista), përmendet në një marrëveshje të bërë midis tij, fisnikëve të tjerë shqiptarë dhe mbretit Karl I Anzhu.

Në marrëveshje thuhet që, “Mbreti Karl aprovon dhe ratifikon traktatin e bërë nga Najron de Toucy kapiten e vikar në Shqipëri, me shqiptarët; me të cilën (traktat) është vendosur që sa herë që forcat ushtarake mbretërore të vendosura në Shqipëri do të marshojnë bashkë me shqiptarët kundër armiqve të tyre, shqiptarët janë të obliguar të dorëzojnë robërit në duart e kapitenit dhe vikarit që ai, Mbreti Karl ka vënë në Shqipëri”.<sup>54</sup> Këtë marrëveshje të cilën Karli I e bëri edhe me fisnikë të tjerë shqiptarë<sup>55</sup>, Vladi duket se nuk e respektoi dhe si rrjedhojë ai u zu në vitin 1279 nga Anzhuinët, nga kapiteni i Durrësit dhe u dërgua në Brindisi i prangosur, ku edhe u burgos.<sup>56</sup> Më vonë ai pranon vasalitetin ndaj Anzhuinëve dhe më 1304 bëhet fisnik, duke marrë titullin *comes*.<sup>57</sup>

Po atë vit dërguan përfaqësuesit e tyre në Napoli edhe familjet e tjera fisnike si Skura, Shpata, Arianiti, Matranga etj., për të shprehur dëshirën, që të viheshin sërish nën sundimin e Anzhuinëve.<sup>58</sup> Në vitin 1319 serbët kishin shtënë në dorë Durrësin. Fuqia e Blinishtëve u rrit edhe më tepër, kur Durrësin e pushtoi Filipi i Tarentit, nipi i Karlit I, duke ia marrë qytetin sërish serbëve në vitin 1322,<sup>59</sup> kësaj radhe edhe me ndihmën e shqiptarëve. Blinishtëve dhe familjeve të tjera me këtë rast iu shtuan privilegjet.

Vladi njëhej edhe si Kasnec Blinishti (Caznecio Blinishti), ngaqë këtë titull e kishte marrë më parë nga serbët.<sup>60</sup> Filipi i Tarentit i jep atij

<sup>54</sup> “*Re Carlo approva e ratifica il trattato fatto da Najron de Toucy capitaneo e vicario in Albania con gli Albanesi; col quale trattato è stabilito che quante volte le milizie regie dimoranti in Albania dovranno marciare con gli Albanesi contro a'loro nemici, gli Albanesi sono obligati dare ostaggi nelle mane del capitano e vicario, che esso re Carlo tiene in Albania*”. AAlb I, nr. 333.

<sup>55</sup> Fisnikët e tjerë ishin: “*Savasto Maurus Scura, Zacharias et Georgius Scura, savasto Yonima, savasto Paulus Verona, savasto Blasius, Savasto Paulus Sanbonbruno, savasto Yetquy, savasto Petrus Misie, Blado Bletista (!) miles, savasto Petrus Clange, savasto Tanusius Bessossia, Theopia miles, savasto Demetrius Limius, savasto Tanus Barbuca, savasto Alexius Arianiti, Paulus Miles*.” AAlb I, nr. 333.

<sup>56</sup> M. Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët ...*, f. 157.

<sup>57</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës...”, në *Lissus*, f. 97.

<sup>58</sup> P. Bartl, *Shqiptarët ...*, f. 33.

<sup>59</sup> *Po aty*, f. 34.

<sup>60</sup> M. Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët ...*, f. 157.

titullin kont, kurse birit të tij Guljelmit, i jepet ofiqi i marshallit të Shqipërisë (*marascallum regni albanie duximus ordinandum*), i cili i shton këtij titulli edhe atë të *kryesevastit* bizantin.<sup>61</sup> Një person tjetër, kushëri me të parët, është edhe Kolajan Blinishti, i përmendur gjatë viteve 1304 dhe 1319, i cili kishte titullin *comes*. Kjo familje fisnike nuk përmendet më vonë, sepse u zhduk gjatë kryengritjes së madhe (1319-1336) që Selia Papnore nderoi kundër serbëve.<sup>62</sup> Sipas Shuflajt, “për asgjësimin e saj patën bashkëpunuar me gjithë shpirt edhe Dukagjinët dhe veçanërisht Topiajt”.<sup>63</sup>

### Nën sundimin e Balshajve

Familje tjetër me rëndësi, që pati influencën e saj në Lezhë ishin edhe Balshajt. Balsha Plaku së bashku me djemtë e tij Strazimirin, Gjergjin I dhe Balshën II nënshtruan shumë feudalë shqiptarë dhe qytete të ndryshme, e bënë Shkodrën kryeqendër të tyre dhe gjatë sundimit të Strazimirit (1362-1372) kufijtë e tyre arritën deri në Mat, në kufi me Topiajt, duke përfshirë kështu brenda territorit të tyre edhe Lezhën.<sup>64</sup> Lezha qëndroi nën sundimin e Balshajve deri në kohën kur sundimtar u bë Gjergji II Balsha, i cili ngaqë kishte pushtet të dobët, nuk mundi ti mbante nën kontroll feudalët e nënshtruar, të cilët filluan të ngrinin krye, siç ishin për shembull Dukagjinët me në krye Pal dhe Lek Dukagjinin, të cilët ia shkëputën atij Lezhën në vitin 1387.<sup>65</sup>

### Si rezidencë e Dukagjinëve

Pas shkëputjes nga Balshajt, Lezha u bë për një farë kohe edhe rezidencë e njëres prej degëve të Dukagjinëve, krahina kryesore e të cilëve duhet të ketë qenë kryesisht në Zadrimë<sup>66</sup> dhe ndërmjet viseve të Lezhës dhe të Fanit, të cilët duhet të kenë qenë pasardhësit e linjës së Tanush II Dukagjinit, të birit të Lekës I.<sup>67</sup> Atyre u përkiste ky qytet në

<sup>61</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës...”, në *Lissus*, f. 98; shih edhe: M. Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët ...*, f. 157.

<sup>62</sup> M. Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët ...*, f. 158.

<sup>63</sup> M. Shuflaj, *Histori e shqiptarëve të Veriut...*, f. 27; shih edhe: M. Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët ...*, f. 158.

<sup>64</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës...”, në *Lissus*, f. 98.

<sup>65</sup> Po aty, f. 98.

<sup>66</sup> AAlb. II, nr. 413.

<sup>67</sup> M. Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët ...*, f. 158; shih edhe: Gjon Muzaka, *Memorie*, përktheu Dhori Qirjazi, Tiranë: Toena, 1996, f. 41.

shek. XIV. Më vonë Tanush Dukagjini me të vëllanë Progonin (të bijtë e Lekë I Dukagjinit) e humbin Lezhën me anë të një marrëveshjeje të bërë në vitin 1393 në këtë qytet.<sup>68</sup>

Ata ia lëshojnë qytetin venedikasve, me kusht që të kishin nga ky qytet një të tretën e të gjithë prodhimit<sup>69</sup> të gëzonin edhe më tej pronësinë e pesë vilave të mëdha me shtëpia përreth (*casalia*), të cilat ishin në zotërimin e kështjellës, dhe të mos linin armiq dhe rebelë të Dukagjinëve që të vendoseshin në territoret e këtij qyteti.<sup>70</sup> Ata e lëshuan qytetin në duart e venedikasve, mesa duket, për shkak të kërcënimit të turqve që kishte filluar të bëhej gjithnjë e më i pranishëm. Ky supozim mbështetet edhe nga një dokument i një viti më vonë, në të cilin flitet për sulme nga ana e turqve mbi fshatrat e Lezhës që kishin mbetur në zotërimin e Dukagjinëve.<sup>71</sup> Megjithatë edhe pse e humbin zotërimin mbi Lezhën, influenca e Dukagjinëve në këtë qytet vazhdoi të ishte e konsiderueshme edhe më tej,<sup>72</sup> sepse ata kishin shpresë se do e rimerrnin qytetin më vonë. Shpresat e tyre morën fund që në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit që sapo kishte nisur, dhe kjo ndodhi kryesisht për shkak të sulmeve dhe plaçkitjeve turke, të cilat arritën kulmin në periudhën e sundimit të sulltan Bajazitit Jëlldërëm.<sup>73</sup> Ata si rrjedhojë bënë një Akt shitjeje, me anë të cilit ja shitën të drejtat mbi Lezhën Johan Barbos, një prokuratori të Republikës, i cili pas kësaj marrëveshjeje do të merrte 1/3 e të ardhurave të qytetit.<sup>74</sup>

<sup>68</sup> *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Pars Prima: Saeculum XIV complectens. Tomus Primus: Ab initio ad usque annum MCCCLXXXIV. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale Napoli/ Istituto di Studi Albanesi del' Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini Venezia/ Ponteficio Istituto di Studi Orientali Roma 1967, nr. 501. (më tej: AAV, I)

<sup>69</sup> AAlb. II, nr. 501, 517; AAV I, nr. 542; shih edhe: *Dokumente për Historinë e Shqipërisë I (1400-1405)*, përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1987, dok. nr. 101.

<sup>70</sup> AAV I, nr. 497; shih edhe: AAlb II, nr. 501.

<sup>71</sup> AAlb II, nr. 517.

<sup>72</sup> S. Pulaha, "Vështrim mbi historinë e Lezhës ...", në *Lissus*, f. 100.

<sup>73</sup> Po aty.

<sup>74</sup> Po aty, f. 100-101.

### Periudha Venedikase

Siç u tha edhe më sipër, Lezhën me të gjithë territorin përreth<sup>75</sup> ia dhanë venecianëve në vitin 1393 dy vëllezër nga familja e Dukagjinëve<sup>76</sup>, Progoni me Tanushin (Tanussius).<sup>77</sup> Dukagjinasi edhe gjatë katër viteve të para të sundimit venedikas, sipas marrëveshjes duhet të merrnin 1/3 nga të ardhurat e qytetit. Këtë të drejtë ata e patën deri në vitin 1401, vit kur ata ia shitën këto të drejta prokuratorit venedikas të sipërpërmendur, Johan Barbo.<sup>78</sup> Në atë kohë Lezha konsiderohej si “syri i djathtë” i Durrësit (*dexter Oculus Durachii*),<sup>79</sup> dhe pa të Durrësi nuk ishte asgjë, sepse përveç mbrojtjes që Lezha ia bënte të mundur Durrësit, ajo ishte



Fig. 1: Muret e kalasë së Lezhës. Foto nga E. Malaj 2013

edhe pika kyçe për tregtinë e këtij qyteti, sepse prej aty furnizoheshin vendet e Sllavonisë me kripë.<sup>80</sup>

Më përpara qyteti kishte pasur të drejta vet-administrimi, por këto të drejta Venediku i suprimoi dhe që në vitin 1394 vendosi që të dërgonte në qytet një proveditor apo kështjellar (*castellanus Alexii*)<sup>81</sup> apo siç quhet ndryshe edhe kapiten<sup>82</sup>,

<sup>75</sup> “*Castrum de Lexio cum toto territorio exterior Venetis traditur*”. AAlb II, nr. 501.

<sup>76</sup> Duhet të përmendet këtu që një autor tjetër, Josef Gelciq, shkruan që Lezha gjatë kësaj kohe nuk ishte nën Dukagjinët por nën Radiq Cërnojeviqin, i cili ia dorëzon Lezhën venedikasve, ndërsa Dulagjinët sundonin në territore që kufizoheshin me këtë qytet. Edhe Dukagjinët ia dorëzuan territoret venedikasve kundrejt një shpërblimi të majmë. Giuseppe Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, përktheu nga origjinali Laura Leka, Tiranë: Shtëpia botuese “55”, 2009, f. 184.

<sup>77</sup> M. von Šufflay, *Städte und Burgen...*, f. 27.

<sup>78</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus...*, f. 101.

<sup>79</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet...”, f. 123.

<sup>80</sup> G. Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve...*, f. 184.

<sup>81</sup> “*Capta: Quia est providendum de removendo a castro Lesii castellanum qui ibi est pro bono agendorum deinde, et de faciendo ibi unum alium castellanum – vadit pars, ut habeatur persona sufficiens que vadat ad dictum locum, quod omnes illi qui vellent ire pro castellanis cum salario ducatorum centum quinquaginta in anno et ratione anni tenendo ad suum salarium et expensas duos famulos ac eundo per duos annos,*

i cili do të merrej me çështjet penale dhe civile të qytetit dhe të kishte një shpërblim vjetor prej 150 dukatësh. Ai kishte si obligim të mbante me shpenzimet e tyre nga kjo shumë edhe dy shërbyes<sup>83</sup> dhe një noter. Kohëzgjatja e kastelanit në këtë detyrë duhej të ishte jo më pak se dy vjet.<sup>84</sup> Në vitin 1402 proveditori i Lezhës kishte zënë rob një ambasador të sulltan Bajazitit, kur ai po kalonte në det pasi kishte qenë në Kotorr, Raguzë dhe në Durrës. Proveditorit i jepet urdhër më 9 prill të atij viti që ta lirojë pa vonesë këtë ambasador dhe t'i kthejë të gjitha gjëra që mund t'i ishin marrë, duke i shprehur edhe keqardhjen për incidentin.<sup>85</sup> Ky proveditor apo kapiten duhet të ketë qenë i njëjti person që kapi edhe disa anije raguzane në vitin 1403.<sup>86</sup> Emri i këtij proveditori përmendet më 11 tetor 1403, ai ishte Tomadus Mauro (*Thomadum Mauro*)<sup>87</sup>.

Po gjatë vitit 1402 ka të dhëna për rënien e një epidemie në Lezhë dhe në qytete të tjera si në Shkodër dhe Drisht, dhe si rrjedhojë kishin vdekur disa balistjerë, të cilët në Lezhë u zëvendësuan me gjashtë të tjerë.<sup>88</sup> Dokumenti nuk na informon për pasoja të tjera të kësaj epidemie, e cila duhet të ketë shkaktuar shumë vdekje në popullsinë e qytetit.

Në qytet, venedikasit deshën të bënin riparime të ndryshme në fortifikimin e tij por u mjaftuan vetëm me urdhra sidomos në vitet 1404, ku flitej për t'i dhënë proveditorit 200 dukatë ari për riparime.<sup>89</sup> Pastaj më 1411, ku proveditori bën kërkesë për të marrë 300, me qëllim që të bënte shumë punime të nevojshme në vend<sup>90</sup> dhe më tej edhe më 1413<sup>91</sup>

*non possendo facere de mercationibus et recedendo ad beneplacitum dominii ...*”.

AAIb. II, nr. 526.

<sup>82</sup> Po aty, nr. 734.

<sup>83</sup> Po aty, nr. 526.

<sup>84</sup> Po aty, nr. 527.

<sup>85</sup> Po aty, nr. 690.

<sup>86</sup> Po aty, nr. 734.

<sup>87</sup> “1403, 11. octobris Ragusii „Miltinus de Priboe facit manifestum, quod ipse habuit et recepit a Boxicho Dragosseuich presente, dante et solvente pro recuperatione duarum barcharum Raguseorum, captarum per Thomadum Mauro proveditorem turris Lessii ...”. Po aty, nr. 734.

<sup>88</sup> “Quia propter epidimiam, que viguit in partibus Scutari, Drivasti et Alexii, defecerunt multi de ballistariis deputatis ad custodiam dictorum locorum...”. Po aty, nr. 693.

<sup>89</sup> Po aty, nr. 754.

<sup>90</sup> “die. xiiij°. Augusti [Mccccxj°] Capta Quod concedatur prouisorii lesij secundum requisitionem suam Quod pro multis laborerijis deinde necessarijs, in suis litteris contentis, et pro reparacione cuiusdam domus, possit expendere iperpera trecenta de

dhe më 1430, por sipas Shuflajt pa ndërmarrë punime konkrete.<sup>92</sup> Megjithatë, gjatë këtij viti (1430) Venediku dërgon në Shqipëri me galerë edhe zëvendëskapitenin e Gjirit Giorgio Vallaresso, që të shohë si është situata dhe të marrë masa për sigurinë e qyteteve sidomos për Durrësin, Ulqinin dhe Lezhën.<sup>93</sup> Bile ata kishin dhënë më parë (1398) edhe udhëzime që të bënin inspektive me qëllim që të rimëkëmbnin Akrolisin që në kohën e tyre ishte shndërruar në gërmadhë, sepse pa të qyteti ishte mjaft i dobët dhe rindërtimi i tij do ta fortifikonte mjaft qytetin.<sup>94</sup> As në të nuk u bënë riparime. Mbase shkak për mosndërmarrjen e riparimeve të tilla ishin të ardhurat e pakta nga qyteti dhe zonat përreth, sepse riparimet duhej të bëheshin me të ardhurat e qytetit dhe inspektorët duhej që të konstatonin se, sa ishin shpenzimet për një riparim të tillë.<sup>95</sup>

*pecunia nostri communis. ASV, Del. Mist. Sen. XLIX/ 48(49)v*”. *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-III-564, Dokumente për Historinë e Shqipërisë të shekullit XV, vëll. III (1411-1415), përgatitur nga Injac Zamputi, Përparime Huta, nr. 50, fl. 65.

<sup>91</sup> “*die dicto [MccccIIj XXVj Septembris], ser vincieura georgio, ser Nicolaus lipamano, Sapientes ordium. Capta Quod concedatur viro nobili ser Petro gradenico, prouisori nostro Alexij, quod possit expendere in reparationibus omnio neccessarijs deinde, videlicet in stallis, balladuris et alijs reparationibus neccessarijs ad muros dicti loci, et etiam pro reparatione domus, in qua habitat, que minatur ruinam ducatos quinquaginta, licet maior quantitas esse neccessaria. de parte - - 65, de Non - - I, non sinceri - - I. ASV, Del. Mist. Sen. L/33v*”. Po aty, fl. 364.

<sup>92</sup> M. von Šufflay, *Städte und Burgen...*, f. 27.

<sup>93</sup> “*Et si Durachii non esset dubium vel periculum, et periculum esset Alexii vel Dulcigni, volumus, quod te exerceas et vigiles ubi erit maius dubium et maius periculum.*” Šime Ljubić, *Listine o odnašajih između južnogo Slavenstva i Mletačke republike*. Skupio i uredio Šime Ljubić, Pravi Clan Jugoslavenske Akademije znanosti i umjetnosti ITD knjiga IX. Od godine 1423 do 1452. Zagreb: U knjizarnica Jugoslavenske Akademije 1891, f. 40.

<sup>94</sup> “*Capta: Item extit supplicatum pro parte ipsorum nobelium Duchainorum, qui dederunt caastrum Alexii in minibus nostril dominii, quatenus, cum ipse locus Alexii sit valde debilis, et super ripa fluminis sit unus mons versus versus ponentem, super quo fuit antiquitus vel civitas vel castrum et adhuc sunt muri alti super quibus, dicunt, leviter posit construe unum pro maiori fortitudine et securitate loci – vadit pars, quod scribatur rectori deinde, quod diligenter et subtiliter examinare debeat ipsa laboreria,...*” AAlb. II, nr. 607.

<sup>95</sup> “*... diligenter et subtiliter examinare debeat ipsa laboreria, et quanta expensa intraret ad faciendum ea ...*”. Po aty.

Në vitin 1440 qyteti u godit nga një zjarr i madh, i cili kishte dëmtuar edhe mallra, sidomos sasi kripe.<sup>96</sup> Përveç kësaj, gjatë kësaj kohe qyteti kërcënohej herë pas here edhe nga turqit.<sup>97</sup> Këto ngjarje e detyruan Republikën e Venedikut që ta rrethonte akropolin me një mur të ri<sup>98</sup>, mbetjet e të cilit gjenden në atë formë edhe në ditët tona.<sup>99</sup> Ndërtimi i këtij muri përfundoi në vitin 1451 me shpenzimet e Venedikut dhe të qytetit të Lezhës.<sup>100</sup> Në maj të vitit 1448 bëhet fjalë për kërcënime nga turq, nënshetas të sulltanit, edhe pse sulltani kishte një marrëveshje paqe me venedikasit.<sup>101</sup>

Po këtë vit, më 4 tetor 1448 në Lezhë bëhet një paqe ndërmjet Venedikut dhe Skënderbeut e fisnikëve të tjerë shqiptarë. Përfaqësues të Skënderbeut ishin Andrea ipeshkëv i Arbrit dhe Gjergj Pelini, abat i Shën Mërisë së Rotecit (në afërsi të Tivarit), kurse për palën venedikase ishin të pranishëm Paul Loredano, kont e kapiten i Shkodrës dhe Andrea Veniero, orator dhe provizor në krahinat e Shqipërisë mesjetare.

Në këtë marrëveshje ndër të tjera, merret vendim nga ana e Republikës së Venedikut që Skënderbeu dhe zotërinjtë shqiptarë të konsiderohen si miq të dashur e të afërm dhe të falen për të gjitha fyerjet

<sup>96</sup> “*Ad secundum. Che alghuni de questa terra havea manda sal ad Alesso avanti el chaxo del fuogo, el quali era sta vendudo la più parte, e non avea fato el pagamento secondo el comandamento de la nostra signoria; siche supplicha umelemente, che quella se degni, che quel, che non hano habudo el suo pagamento si de quello jera vendudo, chome de quel jera romaxo, del qual ne segui pichol dano, e per che d Alesso non seriano mai pagadi, che i siano scritti in la camera vostra da Scutari. Respondeatur, quod super denariis extractis de sale vendito in Alexio, volumus habere informationem, de sale autem, quod remansit ab igne, volumus, ut denarii, qui ex venditione eius extracti sunt aut extrahentur, dividantur per ratam in illos comunes, quorum omne illud sal erat.*” Š. Ljubić, *Listine o odnašajih izmedju ...*, IX, f. 129-130.

<sup>97</sup> M. Šufflay, *Städte und Burgen...*, f. 27.

<sup>98</sup> *Po aty*, f. 27.

<sup>99</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus...*, f. 100.

<sup>100</sup> M. Šufflay, *Städte und Burgen...*, f. 27.

<sup>101</sup> “*Ser Franciscus Capello vult partem suprascriptam cum infrascripta etiam addicione, videlicet. Item quia per pacem dominus Teucrorum promittit punire suos subditos, qui contra nos facerent, et etiam pro locis Scutari et Alexii datur certa quantitas denariorum Teucro, sicut patet per capitula dicte pacis, ex nunc sit captum, quod per viam Durachii mittatur unus notarius nostre cancellarie ad Teucrum cum ilia comissione, que sibi dabitur per collegium, + 51, - 7, - 7.*”, Š. Ljubić, *Listine o odnašajih izmedju ...*, IX, f. 268-269.

dhe sharjet që i kishin bërë në ndonjë mënyrë Sinjorisë.<sup>102</sup> Si pikë tjetër, ishte edhe dhënia e 1400 dukateve Skënderbeut për çdo vit, duke përfshirë edhe një shumë prej 200 dukatësh që ai zakonisht e merrte nga zyra financiare e Durrësit.<sup>103</sup> Po nga kjo zyrë atij do t'i lejohej në të ardhmen që të nxirrte 200 kuaj ngarkesë kripe dhe nuk detyrohej që të paguante asgjë më tepër, përveçse sasisë së thënë.<sup>104</sup> Gjithashtu, Skënderbeut dhe zotërinjve të tjerë të Shqipërisë u lejohej të jepnin e të merrnin me qira apo të bënin tregti me çdo qytetar venedikas, sipas pëlqimit të tyre.<sup>105</sup> Pika të tjera ishin edhe faljet për të gjithë ata persona që kishin marrë pjesë në veprime luftarake kundër Sinjorisë. Këta persona lejoheshin që të ktheheshin në shtëpitë e tyre, dhe të njëjtën gjë duhej t'ua lejonte edhe Skënderbeu dhe zotërinjtë e Shqipërisë, personave që kishin marrë pjesë në luftë kundër tyre në anën e Venedikut.<sup>106</sup>

Venedikasit me anë të kësaj marrëveshjeje kërkonin që të ndreqnin edhe çështjen e disa fshatrave përgjatë Drinit që ishin nën zotërimin e Skënderbeut por që duhej të ktheheshin nën zotërimin e Venedikut, ngaqë i përkisnin këtij shteti.<sup>107</sup> Po ashtu, Sinjoria synonte të rimerrte edhe disa fshatra të tjera në afërsi të Danjës, të cilat i mbante me pa të drejtë nën sundimin e tij, Nikollë Dukagjini.<sup>108</sup> Duhet të thuhet këtu që, para kësaj paqeje Skënderbeu kishte qenë në luftë me Venedikun dhe venedikasit në fillim të vitit 1448 ishin munduar që të gjenin një person të besueshëm, i cili do të vrite Skënderbeun, dhe për këtë do t'i paguanin atij gjithë jetën

<sup>102</sup> “*Et primo, cbe la prefata illustrissima signoria de Veniexia tuol et accepta el prefato signor Scanderbego et Meolo Ducagini in sieme con tuti altri signori de VALbania per boni, veri et cari amiei et vieini, perdonando a tuti ogni inzurie et offexe, che per cadaun muodo I havesseno fato verso la prefata illustrissima signoria de Veniexia.*” *Po aty*, f. 282.

<sup>103</sup> “*Item che la prefata signoria de Veniexia dar dieba al prefato signor Scandarbego ogni anno ducati mille quatroeento, nel qual numero debia entrar i ducati duxento, ch'esso signor Scandarbego soleva haver da la camera de Durazo*”. *Po aty*.

<sup>104</sup> *Po aty*.

<sup>105</sup> *Po aty*.

<sup>106</sup> “*Item che cadaun, che havesse falido a la prefata signoria de Veniexia in la presente guerra del prefato signor Scanderbego, i sia perdonado liberamente, et possino ritornar in le loro habitation. Et cussi versa vice quelli, che havessero falido et rebelado al signor Scanderbego et a gli altri signor d'Albania, i sia perdonado, et possino ritornar per le lor habitation, ut supra.*” *Po aty*.

<sup>107</sup> *Po aty*.

<sup>108</sup> *Po aty*, f. 283.

një provizion prej 100 dukatësh dhe do ta kishin në hirin e tyre.<sup>109</sup> Në lidhje me pushtimin e Lezhës, duhet të thuhet këtu që ishte një dorëzim i qytetit në dorën e turqve dhe ikje e banorëve si në Shkodër.

### Lezha dhe Skënderbeu

Lezha është e lidhur në mënyrë të veçantë me Skënderbeun pas aty u formua Lidhja e Lezhës apo Kuvendi i Lezhës nën udhëheqjen e Skënderbeut, dhe krahas kësaj ngjarjeje është edhe vendi, ku vdiq dhe u varros heroi ynë kombëtar. Le t'i marrim këto dy ngjarje me radhë.

Në lidhje me këtë kuvend fisnikësh ka një mungesë të theksuar dokumentesh dhe asnjë njoftim të asaj kohe, megjithatë mbajtja e tij nuk vihet aspak në dyshim.<sup>110</sup> Njoftimet për të fillojnë në fillim të shek. XVI, dhe ndër autorët kryesorë më të hershëm mund të përmendim këtu Barletin, Dhimitër Frangun dhe Gjon Muzakën.<sup>111</sup> Datën kur u mbledh Kuvendi i Lezhës nuk e kemi të sigurt. Sipas Biemmit mbledhja u bë më 2 mars 1444 (*era pei due di Marzo*),<sup>112</sup> kurse sipas regestit të Kordinjanos dhe të Valentinit ajo datë është një ditë përpara, pra më 1 mars 1444.<sup>113</sup> Barleti nuk na jep një datë për këtë ngjarje, por na jep pjesëmarrësit në këtë kuvend. Aty qenë të pranishëm Gjergj Arianiti (Arianit Golem Topia); Andrea Topia me të bijtë Kominin e Muzakën dhe nipin Tanushin; Nikollë dhe Pal Dukagjini; Gjergj Stres Balsha, vëllai i motrës së Skënderbeut; Stefan Cërnojeviqi i Malit të Zi që kishte për grua një nga motrat e Skënderbeut, së bashku me të bijtë Gjergjin dhe Janin; më tej Lekë Zaharia; Pjetër Shpani me djemtë (Aleksin, Bozhidarin, Vrukon

<sup>109</sup> "1448. 4 maii. Cum quidam fidelis subditus noster, qui est persona bone reputationis et pratica et sagax, diçi fecerit nostro dominio, quod haberet modum dandi vel dari faciendi mortem Scanderbergo inimico nostro, sed vult habere provisionem ducatorum c. in anno; vadit pars, quod respondeatur sibi, quod si ipse dabit vel dari faciet mortem Scanderbergo predicto, sumus contenti dare sibi in vita sua provisionem predictam; et ut libentius ad hanc rem se ponat, dicatur ei, quod volumus habere eum in gratia nostri domini, in omnibus licitis et honestis precipue comendatum." *Po aty*, f. 268.

<sup>110</sup> Oliver Jens Schmitt, *Skënderbeu*, përktheu në shqip Ardian Klosi, Tiranë: K&B 2008, f. 77.

<sup>111</sup> *Po aty*.

<sup>112</sup> Giammaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh*, Seconda Edizione, Brescia: Giammaria Rizzardi 1756, f. 30.

<sup>113</sup> Fulvio Cordignano, Giuseppe Valentini, *Saggio di un regesto storico dell'Albania*, Premiato dalla R. Accademia d'Italia, Scutari: Tipografia dell'Immacolata 1937-1940, nr. 671.

dhe Mirkon); Lekë e Pjetër Dushmani me fqinjë; Teodor Muzaka i Beratit dhe të tjerë<sup>114</sup>. Raguzanët, edhe pse ishin shprehur se do merrnin pjesë, nuk ishin të pranishëm, kurse venedikasit dërguan aty përfaqësuesit e tyre si vëzhgues.<sup>115</sup>

Ky kuvend u mbledh në një kishë të qytetit, të cilën Barleti e quan “faltarja e madhe”<sup>116</sup>, kurse Biemmi e quan atë “kisha kryesore e qytetit” (*Chiesa principate della citta*)<sup>117</sup>, që duhet të ketë qenë katedralja e Shën Kollit.<sup>118</sup> Skënderbeu mbajti para princave të pranishëm një fjalim<sup>119</sup> dhe zgjidhet aty për arsye të përvojës ushtarake dhe karakterit të tij, si prijës i kësaj lidhjeje.<sup>120</sup>



Fig. 2: Kisha e Shënkollit, Lezhë, ku duhet të jetë zhvilluar Kuvendi i Lezhës 1444, me monumentin e varrit të Skënderbeut. Foto nga E. Malaj 2010.

Fjalimi që Skënderbeu mbajti në Lezhë përpara princave të mbledhur jepet qoftë nga Barleti<sup>121</sup>, qoftë nga Biemmi.<sup>122</sup> Pisko e cilëson këtë fjalim si një dëshmi të qartë të zgjuarsisë së Skënderbeut si burrë shteti dhe si një orator i shkëlqyer<sup>123</sup>, dhe për këtë arsye këtë fjalim po e japim më poshtë, në një mënyrë të përafërt sipas versionit të “Anonimit” të

Biemmit, por të shkurtuar dhe të përmbledhur në formë esenciale, ashtu

<sup>114</sup> Marin Barleti Shkodran, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, përkthyer nga Stefan J. Prifti, Tiranë: Mihal Duri, 1964. [=Burime dhe Materiale për Historinë e Shqipërisë 2], f. 92-94; shih edhe: Dhimitër Shuteriqi, *Moti i Madh*, Përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479. Tiranë: Dituria 2006, f. 117.

<sup>115</sup> M. Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave...*, f. 94.

<sup>116</sup> *Po aty*.

<sup>117</sup> G. Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto...*, f. 31.

<sup>118</sup> Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*, Tiranë: Naim Frashëri 1967, f. 84.

<sup>119</sup> F. Cordignano, G. Valentini, *Saggio di un regesto storico ...*, nr. 671.

<sup>120</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 78.

<sup>121</sup> M. Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut...*, f. 94-99.

<sup>122</sup> G. Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto...*, f. 31-37.

<sup>123</sup> Julius Pisko, *Skanderbeg, Historische Studie*, Wien: Frick 1894, f. 21.

siç na e sjell Julius Pisko. Kemi zgjedhur pikërisht përmbledhjen e Piskos përse i përket këtij fjalimi, pasi teksti tek origjinali i Biemmit është shumë i gjatë, rreth 7 faqe dhe do ta kapërcente kuadrin e këtij artikulli:

“Me siguri që është e tepërt që unë Juve, o Princa të shkëlqyer, t’ju rrëfej urrejtjen që kanë turqit ndaj besimtarëve të Zotit Tonë Jezus Krisht. Shumë plagë me të cilat është i mbuluar i gjithë krishterimi dhe vetë Arbëria, e dëshmojnë këtë mjaftueshëm. Edhe Ju, Princa të Arbërisë, e keni marrë vesh tashmë, që armiqtë tanë duan të pasurohen me pronat tona dhe duan të na shfarosin. Më lejoni në fillim të shpjegoj shkaqet e fatit të keq të deritanishëm, me qëllim që ne pastaj të këshillohemi për një zgjidhje efikase.

Me lot gjaku po i vajtojnë popujt e krishterë mosbashkimin e princave të tyre, sepse vetëm këta të fundit e kanë vetë fajin e mjerimit të përgjithshëm. Thërrasin qiellin si dëshmitar, që fuqia otomane do të mund të thyhej me forca të bashkuara.

Por unë nuk dua të ndalem tek fati i trishtë i princave të huaj, se vetë vëllezërit e mi janë vrarë në mënyrë të turpshme. Prandaj më lejoni të tregoj, se përse edhe vetë shtëpia ime u shkatërrua në mënyrë të mjerueshme.

Babai im, shoku Juaj, u sulmua nga sulltani turk me ushtri të shumta e të përgatitura mirë për luftë. Të fuqishmit në afërsi kishin qenë tashmë të detyruar të nënshtroheshin nga fuqia superiore. Askush nuk mund ti ndihmonte, dhe kështu ai që i detyruar të dorëzohej me kushte, të cilat ishin të barabarta me rënien e shtëpisë së tij. Ai vdiq, bijtë e tij u vranë, vetëm unë kam mbetur gjallë, se kështu e deshë Qielli, dhe shpresoj që Ai do të më lejoj që të marr hak për këto krime.

Babai im ra viktimë e mosbashkimit të princave shqiptar; unë po parashikoj edhe sot akoma të njëjtin fat edhe për mbretërinë time. Por edhe Ju, njësoj si unë, ndodheni tashmë buzë greminës! E ç’a mendoni Ju? Se turku po menduaka vallë vetëm për shkatërrimin tim dhe po përgatitet për luftë vetëm kundër meje? O Ju Trima! A nuk po i parandieni rreziqet e papara që po ju kërcënohen? E megjithatë sa me lehtësi do të kishit mundësi, që ngazëllimi juaj i fitores të jehojë shumë shpejt!

Planet dhe përpjekjet e turkut synojnë shkatërrimin e të gjithë neve, prej te i pari deri te i fundit. Nëse ai nuk do të mendonte kështu, nuk do të ishte më turk. Ligjet e tij, zakonet e tij, karakteri i tij, para së gjithash vullneti i profetit të tij Muhamed, e nxisin atë për të shkatërruar gjithçka që mban emrin e Krishtit.

Me sytë e shpirtit unë po shoh Muratin midis vezirëve, ndihmësve dhe nënshtetasve, duke nxjerrë shkumë nga goja prej zemërimit dhe hakmarrjes.

Ai falënderon profetin e tij, që unë i kam dhënë shkas për të pushtuar Arbërinë, si shpërblim për humbjet që ai pësoi nga Hungaria dhe Serbia. Tani ai po u jep urdhra oficerëve të tij për të më asgjësuar dhe pas meje për të drejtuar armët kundër të gjithë princave të tjerë shqiptar; Ju të gjithë ai dëshiron t'ju shohë para vetes në vargonj!

Këto janë planet dhe përpjekjet e turkut; më besoni, besoni në përvojat e mija, në njohuritë e mia në lidhje me atë oborr dhe me zakonet e tij. Mendoni për ngjarjet e tmerrshme të kohërave të sotme dhe të kaluara.

Këto fjalë, o princa, që po duhet t'ju them juve janë shumë serioze, se vetëm unë i ngjas atij mjekut që i shpjegon të sëmurit rreziqet e vuajtjeve të tij, me qëllim që ky të vendosë për të bërë operacionin. – Vetëm të bashkuar ne mund të rezistojmë, dhe këtë bashkim e dëshiron vetë Zoti. Ju e vini re te Hungaria, Zibienbyrgeni, Bullgaria dhe Serbia, që më parë veç e veç ju nënshtruan turkut të gjithë me radhë. Por kur para një viti u bashkuan të gjithë princat e tyre, Qielli i bekoi armët e tyre, dhe kështu ata korrën fitoren e shkëlqyer, fitoren e Krishterimit!

Pra këtë shembull të mrekullueshëm ju e keni para vetes. Oh! Le të shkojmë pra dorë për dorë dhe mbrojtja hyjnore ka për të qenë e sigurt për ne!

A besoni ju se turku do të kishte nënshtruar Arbërinë në kohën e atit tim, nëse princat do të ishin bashkuar? Përçarja e atëhershme ka qenë shkak i vetëm, që vendi ynë i bukur ra viktimë e pushtimit otoman. Na ndihmoftë pra për fitore bashkimi dhe harmonia midis jush, me qëllim që të triumfojmë njësoj si hungarezët mbi armikun e tmerrshëm.

Forcat e Arbërisë i ngjajnë përrënjevë të vegjël që rrjedhin nga drejtime të ndryshme. Dhe kur këta bashkohen në një shtrat të vetëm, formojnë një lum të madh e të fuqishëm. Kjo rrethanë ngjall tek unë një besim të gëzueshëm dhe shpresën, për ta lidhë fitoren e lavdishme në armët arbërore, për ti dëshmuar kështu Krishterimit të Evropës vlerën e tyre. Unë vetë që kam jetuar për tridhjetë vjet në atë oborr dhe që njoh armët e tyre, mënyrën e tyre të luftimit, ushtritë e tyre, lejohem me të drejtë të shpresoj, se mund të dalim tani me sukses kundër tyre. Dhe kur unë si prijës ushtarak i tyre kam mposhtur armiqtë e tyre në shumë luftëra të përgjakshme, si mund të mos dal tani fitimtar, kur po mbroj atdheun tim, të mirën e shokëve të mi, të cilët më kanë besuar jetën, gjakun dhe pronat e tyre?

Mos u frikësoni nga thashethemet boshe në lidhje me fuqinë e armiqtve tanë; para pak muajsh ata u goditën në kokë nga Huniadi dhe bërthama e trupave të tyre u asgjësua. Ajo çfarë ka mbetur ende tek ata, nuk është asgjë tjetër përveçse një grumbull njerëzish të këqij, frikacakë dhe barbarë, pa rregull e pa përvojë. Unë më tej po ju përmend edhe një herë betejën më të fundit të zhvilluar në Moravë, ku Huniadi me një ushtri fare të vogël e bëri copash

ushtrinë turke jashtëzakonisht në numër. Perëndia nuk pyet për numrin e armiqve, kur don tua japë fitoren besimtarëve të Vet. Më besoni, edhe sot turku i ka varur shpresat tek përçarja jonë, përndryshe ai as që guxon të na sulmojë, por edhe po guxoftë, kjo ka për ti kushtuar atij me siguri shumë shtrenjtë.

Ju e shihni pra, o princa të mençur, që shpëtimi ynë varet nga vetë ne. Nëse ne rrimë e shohim duarlidhur rënien e fqinjit tonë, nëse ne rrimë e presim porsì qengja të shtrirë, pa bërë asgjë, do të jemi të gjithë pre e ujkut. Nga ajo çfarë do bëjmë sot marrëveshje varet fati i Arbërisë. Unë ju shpjegova Juve në detaje rrezikun e përgjithshëm dhe mjetet për mënjanimin e tij; dhe vetëm prej Jush varet përbushja e planeve të menduara mirë nga unë; nëse ju i pranoni ato, Arbëria do të shpëtojë dhe brezat e ardhshëm do të luten me mirënjohje për shpirtin Tuaj.

Kështu shpresoj që Zoti i Gjithëfuqishëm, ti këshillojë për mirë princat e Arbërisë dhe vendostë në zemrat e tyre shpirtin e bashkimit, shpirtin e rezistencës kundër armikut të përbashkët!”<sup>124</sup>

Këto pra ishin në mënyrë të përmbledhur fjalët e Skënderbeut në Kuvendin e Lezhës, të cilat Biemmi ia vë atij në gojë dhe që Pisko i sjell edhe në punimin e tij, për të nxjerrë në pah aspekte të figurës dhe të karakterit të heroit.

Aty nuk u formua ndonjë program i vërtetë për ndonjë rend të ri politik<sup>125</sup>, megjithatë si ngjarje, Kuvendi i Lezhës ka rëndësi të madhe, sepse ishte bashkimi i parë politik dhe ushtarak i Shqipërisë<sup>126</sup>, duke formuar një ushtri të përgjithshme, komandant i së cilës u vendos njëzëri Skënderbeu,<sup>127</sup> dhe u krijua madje edhe një arkë e përgjithshme e Lidhjes. Çdo anëtar i Lidhjes ishte i lirë të caktonte vetë ndihmën financiare dhe ushtarake që do të derdhte në këtë arkë dhe të ardhurat e lidhjes arrinin afërisht një shumë prej 200 mijë dukatësh ari.<sup>128</sup>

Megjithëse Lezha pati një rëndësi për veprimtarinë e Skënderbeut, duhet të thuhet këtu që njerëzit e Skënderbeut nuk përtuan që të bënin ndonjë grabitje bagëtish tek banorët e këtij qyteti dhe të rrëmbenin njerëz

<sup>124</sup> *Po aty*, f. 21-23. (Pjesa e mësipërme është përkthyer nga gjermanishtja nga Edmond Malaj duke e krahasuar me origjinalin italisht të Biemmit). shih edhe: G. Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto...*, f. 31-37.

<sup>125</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 78.

<sup>126</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus...*, f. 103.

<sup>127</sup> Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti...*, f. 85.

<sup>128</sup> *Po aty*.

të shumtë.<sup>129</sup> Këto incidente midis Skënderbeut dhe Venedikut po ndodhnin edhe për shkak se Skënderbeu u kishte ofruar strehim në territoret e tij armiqve të Venedikut.<sup>130</sup> Nga ana tjetër, Venedikut nuk i pëlqente forcimi i Skënderbeut dhe në vitin 1448 hyri në një konflikt të armatosur me Lidhjen e Lezhës, por kur rreziku turk filloi ta kërcënonte drejtpërsëdrejti Republikën, ajo filloi të bashkëpunonte me Skënderbeun.<sup>131</sup> Me forcimin e vazhdueshëm të pushtetit të Skënderbeut filluan të zhdukeshin edhe kufijtë e mëparshëm të zotërimeve feudale dhe të shkriheshin në një njësi të vetme të madhe shtetërore.<sup>132</sup> “Në përfundim të këtij procesi, sidomos pas fitores së bujshme të Krujës, u krijua një shtet i përqendruar\* nën pushtetin e Gjergj Kastriot Skënderbeut. Krijimi i tij shënonte një hap përpara në krahasim me gjendjen e mëparshme të anarkisë feudale dhe pas fitores së lirisë nga zgjedha osmane, kjo ishte vepra e dytë e madhe e Skënderbeut.”<sup>133</sup>

Momenti tjetër i rëndësishëm historik në lidhje me Skënderbeun dhe Lezhën është vdekja dhe varrimi i tij në këtë qytet. Skënderbeu kishte shkuar përsëri në Lezhë për të mbledhur sërish kuvendin, me qëllim që të gjente burime të reja për luftën kundër turqve, sepse në korrik të vitit 1467 e gjithë ushtria osmane me sulltan Mehmetin II në krye ishte vërsulur përsëri kundër trojeve shqiptare.<sup>134</sup> Një betejë e përgjakshme u zhvillua në Buzurshek të Elbasanit dhe Kruja u rrethua për të tretën herë, por Sulltan Mehmeti nuk arriti ta pushtonte dhe për të tretën herë u largua me turp, duke e ndërprerë rrethimin.<sup>135</sup>

Por gjatë kësaj kohe, kur Skënderbeu arriti në Lezhë ai u sëmur rëndë nga ethet dhe nuk mundi as të merrte pjesë në sulmin dhe në fitoren e ushtrisë së tij kundër një ushtrie turke që kishte ardhur nga Kosova me qëllim që të sulmonte Shkodrën.<sup>136</sup> Skënderbeu vdiq më 17 janar të vitit

<sup>129</sup> AAV, XVIII, nr. 5009.

<sup>130</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus...*, f. 103.

<sup>131</sup> Po aty.

<sup>132</sup> K. Frashëri, *Historia e qytetërimit shqiptar...*, f. 114.

\* Shteti i përqendruar shqiptar i Skënderbeut përfshinte brenda tij zotërimet e Kastriotëve, Topiajve, Muzakajve, Arianitëve, Gropajve, Jonimëve, Stresëve etj., dhe kufijtë e tij shtriheshin nga Velipoja e Shkodrës në perëndim deri në Seman në lindje. Shih, *po aty*, f. 115.

<sup>133</sup> *Po aty*, f. 114-115.

<sup>134</sup> *Po aty*, f. 133.

<sup>135</sup> *Po aty*.

<sup>136</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus...*, f. 104.

1468 dhe e varrosën në Katedralen e Shën Kollit<sup>137</sup>, me nderime të mëdha. Datën e vdekjes së tij (17 janar) na e jep G. Maria Biemmi, por vitin ai e vendos më 1467.<sup>138</sup>

Njëmbëdhjetë vjet më vonë, kur turqit pushtuan Lezhën në vitin 1478, ata ia thyen varrin dhe i shpërndanë në të gjitha drejtimet kockat e prijësit të famshëm, për t'i përdorur si talismanë.<sup>139</sup> Sipas Babingerit, “Mehmeti e pushtoi edhe Lezhën urdhëroi të hapej varri i njeriut të cilit i qe trembur aq shumë dikur dhe eshtrat e tij të nxirreshin përjashta për ti parë të gjithë.”<sup>140</sup>

### **Pushtimi osman**

Lezha nuk pati një fat më të mirë pas pushtimit. Atë e përfshiu vala e shkatërrimit. Në lidhje me pushtimin e Lezhës, duhet të thuhet këtu që ishte një dorëzim i qytetit në dorën e turqve dhe ikje e banorëve si në Shkodër. Qyteti u dogj. Zjarrin qytetit ia vuri Daut Pasha, bejlerbegu i Rumelisë, i cili shkoi aty me një ushtri të fortë dhe kjo duhet të ketë ndodhur më 9 shtator 1478.<sup>141</sup> Kur ushtria e këtij të fundit u kthye në Shkodër solli me vete 50 të kapur rob në një anije venedikase dhe shumë të tjerë në ishullin e Drinit, të cilët pastaj i sollën para mureve të Shkodrës dhe i vranë.<sup>142</sup> Sipas kronistit osman Hoxhë Saddedini, nuk ishte vetëm një anije por disa. Ishulli i Drinit që përmendet më sipër nga Barleti mbase është vendi i quajtur sot “*Ishulli i Lezhës*”. Sot aty nuk ka ishull, por ndoshta një i tillë ka ekzistuar në kohën gjatë shek. XV, kur rrjedha kryesore e Drinit kalonte nga Lezha. Ja si e përshkruan Hoxhë Saddedini kapjen rob të ekuipazheve të këtyre anijeve, që përbëheshin jo

<sup>137</sup> Kristo Frashëri, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Jeta dhe Vepra (1405-1468)*, Tiranë: Toena 2002, f. 468.

<sup>138</sup> G. Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto...*, f. 478.

<sup>139</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet...”, f. 123.

<sup>140</sup> Franc Babinger, *Mehmet Pushtuesi. Botësulmuesi në kapërcyell kohe*, vëll. I, përkthyer nga Afrim Koçi, Tiranë: 55, f. 382.

<sup>141</sup> Joseph von Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches*. Band 2. Einleitung und Bibliographie Prof. Dr. Herbert W. Duda. Eilftes Buch. Graz: Akademischer Druck und Verlagsanstalt 1963. (=Veröffentlichungen der Hammer-Purgstallgesellschaft. Hrsg. v. Franz Sauer. Reihe A. Joseph v. Hammer-Purgstall. Werke. Geschichte des Osmanischen Reiches. Band 1-10), f. 164.

<sup>142</sup> Marin Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, Përkthye prej origjinalit latinisht nga Henrik Lacaj, Botim i dytë i shtuar, Tiranë: Universiteti i Tiranës 1967, f. 100. (=Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë 1.), f. 101.

vetëm nga ushtarë por edhe nga familje që po kërkonin të arratiseshin:

“Disa komandantë frëngj të ardhur nga ana e frëngut për të qeverisur kështjellën, mbasi futën në anije familjet e tyre së bashku me plaçkat u arratisën, duke shpresuar të arrinin në det nëpërmjet lumit të rrëmbyeshëm që rridhte rrëzë kështjellës. Me një fjalë kur ushtria botëshkelëse mbretërore arriti në brigjet e atij lumi dhe pa anijet që po arratiseshin, duke rrëshqitur gjatë lumit dhe ata armiq të denjë për tu vlarë, që kishin hapur krahët e arratisë, atëherë trimat të armatosur me hanxharë e të etur për gjak armiku dhe notarët të pashoq në artin e kredhjes në ujë, u ç’veshën lakuriq si shpatat dhe u hodhën në atë lumë të thellë. Turma e frëngjve që kishte hipur në anijet, kur pa afrimin si krokodilë të atyre trimave, u frikësua dhe kuptoi se barka e jetës së tyre do të mbytej. Ata [me vështirësi] arritën në breg dhe u arratisën në pyll. Ndërsa nga ana tjetër luftëtarët fitimtarë i tërhoqën anijet, të cilat ishin të mbushura plot e përplot me sende, plaçka, me vajza të një bukurie të rrallë dhe i prunë në vendin ku ndodhej ushtria. Njëkohësisht dërguan përsëri njerëz me anijet e kapura për të ndjekur të poshtrit, të cilët u arratisën. Të gjithë i kapën i lidhën me zinxhirë dhe i çuan në selinë e lartë.”<sup>143</sup>

Pas pushtimit qyteti hyri nën administrimin osman dhe i përkiste nahijes së Dukagjinit.<sup>144</sup> Pushtetin aty e drejtonte një subash që ishte nën varësinë e sanxhakbeut të Dukagjinit, i cili kishte një zëvendës (vaib), një llogaritar, komandantin e kështjellës (dizdarin) me ushtarë dhe kujdestarin e tregut (bazhdarin).<sup>145</sup>

### **Ekspedita e Gjon Kastriotit**

Menjëherë pas pushtimit osman plasën edhe një sërë kryengritjesh nga veriu në jug. Këtu së pari mund të përmenden kryengritjet e ndërmarra nga Gjon Kastrioti i biri i Skënderbeut rreth vitit 1481, i cili zbarkoi në Durrës dhe krijoi një ushtri prej 4000 këmbësorësh shqiptarë

<sup>143</sup> Hoxha Sadeddin (Hoxha Sad-eddin b. Hasan xhan b. Hafiz Muhammed Isfahai 1536-1599), “Pushtimi i Shkodrës”, në *Lufta Shqiptaro-Turke në shekullin XV*, Burime Osmane, përgatitur për shtyp nga Selami Pulaha, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1968, f. 267.

<sup>144</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus*, f. 104.

<sup>145</sup> Po aty.

dhe 600 kalorësish.<sup>146</sup> Për këto ngjarje na njoftojnë dorëshkrimet e Stefano Manjos. Sipas këtyre dorëshkrimeve, shqiptarët kishin shkuar vetë ta kërkonin Gjonin në Pulja, i cili në atë kohë shërbente në ushtrinë e dukës së Kalabrisë.<sup>147</sup> Duka i Kalabrisë e transporton Gjonin me ushtri me disa galera të flotës së vet mbretërore dhe bashkë me Gjonin ishin edhe një kushëri i tij nga nëna, Konstantin Muzak Karli dhe Klada prej Majnës që jetonte në Koronë.<sup>148</sup> Pasi pati disa suksese të pjesshme në përballjet me osmanët, në shtator të vitit 1481u përpoq që të merrte edhe Krujën, por nuk ia doli pasi kështjella kishte një numër të madh turqish, të armatosur mirë.<sup>149</sup>

Gjoni me ushtri u nis pastaj në krahinën e Himarës dhe të Sopotit që u çliruan përkohësisht, duke shkaktuar vdekjen e rreth 1.000 ushtarëve turq. Për humbjet në anën e Gjonit nuk jepen të dhëna. Më pas ai mori edhe disa krahina të tjera, mes tyre edhe Stelushin që dikur i kishte përkitur Skënderbeut.<sup>150</sup> Megjithatë sukseset e tij nuk patën një vazhdimësi sepse operacionet e ushtrive turke që vazhduan gjatë viteve 1482-1483 bënë të mundur ripushtimin e këtyre krahinave dhe e rivendosën sundimin në vitin 1484 edhe në kështjellën e Himarës.<sup>151</sup> Gjon Kastrioti u detyrua që të kthehej në Itali,<sup>152</sup> dhe duket se kaloi ndonjë sëmundje mendore, sepse disa vite më vonë një murg predikues fra Françesku nga Kruja, për të cilën do të flasim më poshtë, njofton se Gjoni ishte çmendur dhe rrinte në një kështjellë të Otrantos, dhe për këtë shkak shqiptarët nuk e donin më.<sup>153</sup>

<sup>146</sup> “[...] e ‘l fio de Scanderbec continua la so impresa, con 4.000 Albanesi e 600 cavalli’”. *Dokumente të shekullit XV për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV (1479-1506), Pjesa I (1479-1499), përgatitur nga Injac Zamputi, Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës 1967, nr. 79; shih edhe: *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Lufta shqiptaro-turke e shekullit XV*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1967, f. 104.

<sup>147</sup> *Dokumente të shekullit XV për historinë e Shqipërisë...*, vëll. IV, nr. 79.

<sup>148</sup> *Po aty*.

<sup>149</sup> *Po aty*.

<sup>150</sup> *Po aty*.

<sup>151</sup> *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Lufta shqiptaro-turke ...*, f. 105; shih edhe: S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus*, f. 105.

<sup>152</sup> *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Lufta shqiptaro-turke ...*, f. 105.

<sup>153</sup> *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëll. II, (shek. VIII-XV), përgatitur nga Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pipo, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1962, nr. 259.

### **Lezha dhe ekspedita e Skënderbeut të Ri**

Më tej, mund të përmendet kryengritja e organizuar nga kuvendet në vitet 1494-1495, në kohën kur mbreti i Francës, Karli VIII kishte zbritur në Itali dhe planifikonte të hidhej në Ballkan.<sup>154</sup> Kuvendet nëpërmjet kryeipeshkvit të Durrësit Martin Firmano, po mundoheshin sërish të lidheshin me Kastriotët në Itali, sidomos me Skënderbeun e Ri (nipin e heroit), dhe ky i fundit po përpiqej të sillte në Shqipëri armë për 30.000 kryengritës<sup>155</sup>, por në këto përpjekje, u pengua nga Venedikasit të cilët nuk u mjaftuan vetëm me arrestimin e kryeipeshkvin Firmano, por madje nëpërmjet Alvise Sagondino njoftuan edhe Stambollin për kryengritjet e shqiptarëve, duke pohuar pranë Portës se këto kryengritje nuk kishin qenë qëllimi i Sinjorisë.<sup>156</sup> Si rrjedhim, kryengritja dështoi.

Ndërkohë synimet turke dhe veçanërisht krijimi i një flote nga ana e tyre në Adriatik e shqetësuan Republikën e Venedikut, e cila papritmas kishte nevojë për kryengritjen e shqiptarëve. Ajo e nxori sërish nga burgu kryeipeshkvin e Durrësit Marin Firmanon dhe e dërgoi në Shqipëri me emisarët e saj, për të nxitur shqiptarët.<sup>157</sup> Firmano kthehet në Durrës dhe vendoset në një fshat të tij. Në muajin gusht 1499, venedikasit e kontaktojnë sërish Firmanon me anë të bajlit të Durrësit. Aty shkuan edhe kryepleq të fshatrave të tjera, ku shprehën hapur mërzinë për pagesat e haraçit që i paguanin sulltanit, kështu që “shumë prej atij vendi ishin të gatshëm të çoheshin në kryengritje kundër sulltanit”<sup>158</sup>. Emri i fshatit ku u bë ky takim nuk jepet në dokument, gjithashtu nuk përmenden as emrat e kryepleqve.

Venediku synonte që të krijonte një kryengritje lokale në Shqipëri, të përqendruar përreth Lezhës, ku planifikonte të zbarkonte. Shqiptarët nga ana tjetër donin një kryengritje të përgjithshme për çlirimin e të gjithë vendit. Kjo krijoi mosmarrëveshje të mëdha që u acaruan deri në atë pikë, sa Republika, me anën e bajlit të Durrësit, e helmoi Martin Firmanon në vitin 1499.<sup>159</sup>

Roli i klerit për organizimin e kryengritjeve antiosmane bie në sy në shumë dokumente. Përveç rastit të Firmanos, përmendet edhe një rast

<sup>154</sup> S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus*, f. 105.

<sup>155</sup> *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëll. II, nr. 257.

<sup>156</sup> *Po aty*.

<sup>157</sup> *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Lufta shqiptaro-turke ...*, f. 107.

<sup>158</sup> *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë ...*, vëll. II, nr. 258.

<sup>159</sup> *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Lufta shqiptaro-turke...*, f. 107.

tjetër. Kështu p.sh., radhe përmendet frati predikues i urdhrin të Shën Françeskut të Vinjës, fra Françesku i Krujës, i cili kishte ikur dhe ishte vendosur në Zarë. Ai kishte shkuar sërish në Shqipëri, kishte predikuar për luftën kundër turqve, shkon në Venedik dhe njofton se shqiptarët ishin mbledhur në shumicë të madhe, më shumë se 20 mijë.<sup>160</sup> Ata do të donin për kryetar të birin e të birit të Skënderbeut, dhe nëse do të kishin atë si prijës të tyre, do të ngrinin krye kundër sulltanit dhe si frat, ai thoshte se e dinte që Skënderbeu i ri do të vinte me qejf, dhe prandaj për hir të krishterimit, për të shtënë në dorë atë Shqipëri, i lutej shumë Sinjorisë që të vepronte.<sup>161</sup> Këto veprimtari të fra Françeskut të Krujës duhet të kenë ndodhur në vitet 1498-99.

Kjo është pikërisht koha kur në vitin 1499 në rrethinat e Lezhës shpërtheu një kryengritje kundër garnizoneve turke, funksionarët turq u dëbuan dhe kryengritësit thirrën në krye të tyre, djalin e Gjonit, nipin e Skënderbeut, që kishte të njëjtin emër si gjyshi i tij, pra Gjergj Kastrioti dhe që u mbiquajt Skënderbeu i Ri.<sup>162</sup> Banorët e Lezhës po e prisnin me padurim ardhjen e tij. Në lidhje me këtë pritje, frati minorit Bernardini nga Shkodra, guardian i Shën Mërisë në një letër më 4 qershor 1500, të shkruar në Lezhë, njofton se “aty pritet Skënderbeu ashtu sikundër pritet Mesia prej judejve, së bashku me z. Shpan Dukagjinin dhe, si ta marrë Ishullin e Lezhës e si ta fortifikojë, do të rrethojë Shkodrën e Krujën dhe të gjitha vendet e tjera”<sup>163</sup>.

Pra, pritisshmëria nga ky pasardhës i Gjergj Kastriotit ishte e madhe dhe mbahej se ishte personalitet me famë të madhe.<sup>164</sup> Skënderbeu i Ri, pasi qëndroi një vit në Venedik, u nis për në Shqipëri me një ushtri prej 150-200 stratotësh dhe zbarkoi në Ishullin e Lezhës më 5 mars 1501, i shoqëruar edhe nga një proveditor venedikas, i quajtur Anton Bon, i cili kishte me vete edhe sekretarin e tij, Jakob Trevizanin.<sup>165</sup> Në mars të vitit 1501, përveç Ishullit të Lezhës, ishte i çliruar edhe Lezha, e cila ra sërish në duart e Venedikasve.<sup>166</sup>

<sup>160</sup> *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë...*, vëll. II, nr. 259.

<sup>161</sup> *Po aty*, nr. 259.

<sup>162</sup> *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Lufta shqiptaro-turke ...*, f. 108.

<sup>163</sup> *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë ...*, vëll. II, nr. 260.

<sup>164</sup> *Po aty*, nr. 261.

<sup>165</sup> *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1479-1506)*, Pjesa II (1499-1506), përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1979, nr. 206.

<sup>166</sup> M. Šufflay, *Städte und Burgen...*, f. 28.

Një rol të madh në rënien e Lezhës plotësisht në duart e Venedikut luajti edhe sekretari i sipërpërmendur Jakob Trevizan. Ai u nis në Lezhë për bisedime, i maskuar fillimisht si një tregtar dhe shkoi së pari në shtëpinë e Dom Pjetër Malonsit, ipeshkvit të Lezhës për të biseduar aty me pleqtë për marrjen e qytetit.<sup>167</sup> Nga një organizim i brendshëm u bë e mundur kapja rob e eminit të sulltanit.<sup>168</sup> Gjithë kjo ngjarje më tepër ngjet se ka ndodhur në Ishull-Lezhë sesa në Lezhë, pasi këto të dhëna të nxjerra nga ditarët e Marino Sanudos, në këtë rast nuk janë shumë të qarta. Gjithsesi, Flamuri i Shën Markut u ngrit të dielën e 7 marsit dhe aty u gjetën edhe 1.500 stara grurë, gjysmën e të cilit Skënderbeu i Ri ua fali popullit për haraçet që i kishin paguar sulltanit dhe gjysmën tjetër e mbajti për shpenzimet e veta.<sup>169</sup>

Skënderbeu i Ri e merr Lezhën në një gjendje të mjeruar, pjesë të tëra të qytetit, si p. sh. qyteti i vjetër që arrinte deri në breg të Drinit ishte i rrënuar dhe i pabanuar. Në gjendje të keqe ishte edhe kështjella.<sup>170</sup> Megjithëkëto suksese të fillimit, shqiptarët duket se u zhgënjyen me Skënderbeun e Ri dhe nuk po i jepnin rëndësi aq sa duhej ngaqë kishte ardhur me një ushtri fare të vogël dhe me pak pajisje.<sup>171</sup> Përveç faktit që ndihmat venedikase ishin të pakta, midis Skënderbeut të Ri dhe proveditorit venedikas filluan të lindnin edhe mosmarrëveshje, të cilat e ulën hovin e kryengritjes dhe si rrjedhim që në përlëshjet e para që patën stratiotët e Gjergjit me ushtarët turq, pësuan dëmtime dhe humbje të rënda.<sup>172</sup>

Menjëherë pas këtyre ngjarjeve turqit pushtojnë më 13 gusht 1501 Durrësin, i cili tashmë që para rënies ishte katandisur në një gjendje të mjeruar dhe me mure mbrojtëse të rrënuara,<sup>173</sup> për të cilin edhe pelegriini gjerman Arnold fon Harff, që kaloi aty gjatë udhëtimit të tij për në Jerusalem, shkruan që ishte një qytet i madh e i trazuar (*dit is eyn groysse verstoerte stat*).<sup>174</sup> Pas pushtimit të Durrësit, Venediku filloi bisedimet

<sup>167</sup> *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1479-1506) ...*, Pjesa II, nr. 206.

<sup>168</sup> *Po aty*.

<sup>169</sup> *Po aty*.

<sup>170</sup> *Po aty*, nr. 210, ref. 9.

<sup>171</sup> "... et il Sig. Scanderbecho infra in Alexio ma per voler in quella reputacion si credeva e venuto con poca zente e Albanesi non fanno quel caso ec.". *Po aty*, nr. 213.

<sup>172</sup> *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Lufta shqiptaro-turke ...*, f. 108.

<sup>173</sup> M. Šufflay, *Städte und Burgen...*, f. 22.

<sup>174</sup> *Die Pilgerfahrt des Ritters Arnold von Harff von Cöln durch Italien, Syrien, Aegypten, Arabien, Aethiopien, Nubien, Palästina, die Türkei, Frankreich, und*

me osmanët, sepse synonte që të evitonte humbjen e qyteteve të tjera që posedonte akoma si Lezhën, Ulqinin dhe Tivarin dhe më 14 dhjetor nënshkroi një paqe, pas së cilës i braktisi kryengritësit shqiptarë.<sup>175</sup> Disa muaj më vonë, në shkurt të 1503 u largua për në Itali edhe Gjergj Kastrioti, Skënderbeu i Ri, dhe në muajin korrik të vitit 1506 Lezha ra sërish në duart e osmanëve.<sup>176</sup> Ja si e përmend, Marino Sanudo, në ditarin e tij dorëzimin e Lezhës tek osmanët:

“Nga Lezha [letër] e Kapitenit të galerave bastarde z. Dominiko Dolfin dhe të soprakomitit e zëvendëskapedan i Gjirit, z. Almaro Pizani. [Thonë] se, sipas urdhëresave, ua treguan atyre [banorëve të Lezhës] mendimin e Sinjorisë sonë që t’i jepej ai vend sulltanit. Ata donin të mbroheshin. Më në fund u hoqën artileritë dhe ata [banorët?] e dogjën të gjithë vendin. Dhe banorët, një pjesë kërkuan dhe u bartën në Ulqin, dhe një pjesë gjetkë në Pulje. Kështu që ai vend që djegur dhe shpopulluar dhe po pritej i dërguari i sulltanit aty gjendej edhe një galerë e soprakomitit z. Sebastian Foskarinit ....”<sup>177</sup>

Pra, siç e mësuam edhe nga dokumenti i mësipërm, ashtu si në shumë qytete të tjera, edhe në Lezhë popullsia e mëparshme pothuajse nuk ekzistonte më, pasi u largua, dhe qyteti mori një karakter ushtarak-administrativ osman,<sup>178</sup> duke u zvogëluar gjithnjë e më tepër, saqë në shekujt e mëvonshëm do të dukej më tepër si fshat, sesa si qytet. Si i tillë Lezha filloi të bëhej sërish kryesisht në shek. XX.

\* \* \*

Si përfundim, mund të themi, se ky ishte edhe fundi i qytetit mesjetar të Lezhës, apo të Lisit, i cili u rimëkëmb shumë ngadalë, por që humbi njëherë e përgjithmonë trashëgiminë e tij kulturore dhe intelektuale që kishte arritur në Mesjetë. Dëmet që u bënë ishin jashtëzakonisht të mëdha, qoftë nga pushtimet e herëpashershme qoftë edhe nga djegiet e

Spanien, wie er sie in den Jahren 1496 bis 1499 vollendet, beschrieben und durch Zeichnungen erläutert hat. Nach den ältesten Handschriften mit deren 47 Bildern in Holzschnitt herausgegeben von Dr. E. von Groote. Cöln: Heberle (H. Lempertz)1860, f. 65.

<sup>175</sup> *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Lufta shqiptaro-turke ...*, f. 108.

<sup>176</sup> *Po aty*.

<sup>177</sup> *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1479-1506)...*, Pjesa II, nr. 449.

<sup>178</sup> *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Lufta shqiptaro-turke...*, f. 109.

disahershme, qoftë nga pushtuesit turq,<sup>179</sup> qoftë edhe nga banorët vetë.<sup>180</sup> Kështu që, sot, përveç disa mureve që u përkasin epokave të ndryshme të historisë, nuk trashëgojmë as ndërtesa të plota nga periudha mesjetare, dhe as jemi në gjendje të ndërtojmë një histori të plotë mesjetare të qytetit, për shkak të mungesës së dokumenteve dhe dëshmive të tjera.

### *S u m m a r y*

#### LEZHA IN THE MIDDLE AGES

The article aims to give a history of the city of Lezha during the Middle Ages, from the earliest period to the final invasion of the Ottomans in the early 16th century. Here I focus mainly on the most important events, at the same time I make a periodization of the medieval history of Lezha. The article is based either on historical, scientific literature or on many archive documents that shed more light on the events mentioned above. The article also refers to the connections Skanderbeg had with this city, focusing mainly on the League of Lezha in 1444. One sub-chapter is also devoted to the efforts of New Skanderbeg, the nephew of Georg Kastrioti, to liberate once more the lands of its ancestors from the Ottoman conquest, and as a center of insurgency within its expeditions was precisely Lezha with the surrounding areas.

---

<sup>179</sup> J. Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches...*, 2, f. 164.

<sup>180</sup> *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1479-1506)...*, Pjesa II, nr. 449.